Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufijtë e lartë monetarë, nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave i refuzon ato, duke i skualifikuar nga procedura, pa i kërkuar sqarim ofertuesit/sve.

Në procedurat e prokurimit me vlerë mbi kufijtë e lartë monetarë, nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave duhet ti kërkojë operatorit ekonomik të paraqesë brenda tre ditëve pune, shpjegime të çmimit ose kostove të propozuara në ofertë, në përputhje me nenin 93 të LPP-së dhe të vlerësojnë informacionin e dhënë, në konsultim me ofertuesin, në përputhje me dispozitat e këtij neni.

4. Nëse, Autoriteti/Enti Kontraktor duhet të rishpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna, nuk duhet të vijojë me

Në çdo rast, ofertuesi ka detyrimin të justifikojë dhe dokumentojë me prova me shkrim, shpjegime për elementin/elementët specifike të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 93 të LPP-së.

2.1 Formula që duhet zbatuar, për të vlerësuar një ofertë anomalisht të ulët, në rastin kur ekzistojnë tre ose më shumë oferta të vlefshme, është si më poshtë:

O - Oferta

MO – Mesatarja e ofertave të vlefshme

N - Numri i ofertave të vlefshme

PR (Zm) – Zbritje e mundshme

$$MO = O1 + O2 + O3 + \dots On / N$$

$$PR = 85 \% Mo$$

Vlera e ofertave të vlerësuara < .. PR rrjedhimisht oferta është anomalisht e ulët

3. Nëse një Operator Ekonomik nuk pranon korrigjimin e gabimeve aritmetike, ose nëse Ofertuesi nuk arrin të japë një justifikim për të bindur Autoritetin Kontraktor, në rast të një oferte anomalisht të ulët, Oferta e tij do të refuzohet.

4. Procesi i hedhjes së shortit

Nëse dy ose më shumë oferta kanë të njëjtin çmim më të ulët ose kanë të njëjtat pikë, atëherë fituesi përcaktohet me short, në prani të ofertuesve. Ofertuesit njoftohen për datën dhe kohën e hedhjes së shortit. Mospjesëmarrja e ofertuesve gjatë procesit të hedhjes së shortit nuk përbën arsye për skualifikim.

D. DHËNIA E KONTRATËS

23. Njoftimi i Fituesit 1. Brenda afatit të vlefshmërisë së Ofertës, Autoriteti Kontraktor njofton Operatorin Ekonomik të suksesshëm se, Oferta e tij është pranuar, dhe është shpallur fituese.

24. Nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër/ Kontratës 1. Pas konfirmimit të fituesit/ve Autoriteti Kontraktor përgatit, nënshkruan dhe fton Operatorin/ët e suksesshëm Ekonomik të nënshkruajë Marrëveshjen kuadër/Kontratën.

2. Autoriteti Kontraktor i kërkon fituesit një sigurim për realizimin e Kontratës. Shuma e mbulimit për realizimin e kontratës do të jetë 10% e vlerës së Kontratës. Formulari i Sigurimit të Kontratës, dorëzohet para nënshkrimit të Kontratës.

Sigurimi për realizimin e kontratës mund të paraqitet në një nga format e mëposhtme:

- a) mundësi pagese nga ofertuesi në vlerë monetare, në llogarinë e autoritetit ose entit kontraktor;
- b) garanci bankare;
- c) garanci nga shoqëri sigurimi.

DH. ANKESAT

25. Procedura e ankesës

1. Çdo Operator Ekonomik, i cili ka interes të ligjshëm për objektin e prokurimit dhe rrezikon të dëmtohet nga vendimmarrja e autoritetit kontraktor mund të paraqesë ankesë njëkohësisht pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në lidhje me Dokumentet e Tenderit, kualifikimin, përzgjedhjen ose përcaktimin e ofertës fituese, sipas parashikimeve në LPP dhe aktet nënligjore, në Sistemin e Ankesave Elektronike.
2. Në rastet e ankesave për vendimet e autoritetit kontraktor për përzgjedhjen e kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, operatorët ekonomikë, të cilët kanë marrë pjesë në procedurën e prokurimit dhe mund të cenohen nga ankesa e paraqitur, kanë të drejtë të paraqesin argumentet e tyre në lidhje me këtë të fundit njëkohësisht pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik, në Sistemin e Ankesave Elektronike.

Kundër vendimit të autoritetit kontraktor, operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën, kanë të drejtën të ankohen pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

3. Autoriteti Kontraktor mund t'i kërkojë Komisionit të Prokurimit Publik që të lëshojë masa të ndërmjetme për mospezullimin e procedurës së prokurimit.

E. ANULIMI I PROCEDURËS

26. Anulimi i procedurës

1. Autoriteti kontraktor publikon Njoftimin për Anulimin e Procedurës së Prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç publikon Njoftimin e Kontratës, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e skadimit të afatit të fundit për paraqitjen e ankesave, ose dhënien e vendimit përfundimtar për ankimin.
2. Autoriteti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:
 - a) nuk është paraqitur asnjë kërkesë e përshtatshme në procedurat me faza;
 - b) nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë;
 - c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;
 - d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit kontraktor ka ndryshuar;
 - e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP;

Gjithashtu, Titullari i autoritetit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 të LPP dhe nenin 75 të VKM 285/2021, të ndryshuar.

rishpalljen e saj në Sistemin e Prokurimit Elektronik përpara përfundimit të afateve të ankimimit/shqyrtimit të ankesave dhe vendimit të marrë lidhur me to.

3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.

SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1: Formulari i Ofertës Ekonomike

Shtojca 2: Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit.

Shtojca 3: Formulari i Sigurimit të Ofertës

Shtojca 4: Lista e Informacionit Konfidencial

Shtojca 5: Deklaratë mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit

Shtojca 6: Formulari i Specifikimeve Teknike

Shtojca 7: Formulari i shërbimeve dhe Grafikut të ekzekutimit

Shtojca 8: Termat e Referencës

Shtojca 9: Formulari i Kriteve të Përzgjedhjes së Ofertuesve

Shtojca 10: Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit

Shtojca 11: Formulari i Njoftimit të Skualifikimit

Shtojca 12: Formulari i Njoftimit të Fituesit pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Formulari 13: Formulari i Njoftimit të Fituesit në përfundim të afateve të ankimit

Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimit

Shtojca 15: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër në përfundim të afateve të ankimit

Shtojca 16: Formulari i Njoftimit të Anulimit të Procedurës së Prokurimit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimit

Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE⁵

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.
- (c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Shërbimet për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
- (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme::
 - 1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
 - 2. Njoftimin e Kontrates;
 - 3. Kriteret e Përzgjedhjes;
 - 4. Specifikimet teknike, grafikun e realizimit, termat e referencës;
 - 5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
 - 6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
 - 7. Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit.

⁵ Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

(e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- [Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];

(f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- [Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 2.*(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)***LISTA E ÇMIMEVE SIPAS ELEMENTËVE PËRBËRËS TË SHËRBIMIT****Data:** _____**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:**
_____**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE):** _____**Monedha:** _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë elementëve përbërës të ofertës ekonomike duhet t'u vendoset çmimi i ofruar në këtë Listë, pasi elementët e Ofertës ekonomike pa vlerë do të konsiderohen si shërbime të paofruara dhe do të cojnë në refuzimin e ofertës.

1	2	3	4	5	6
Nr. Anali zë	Emërtimi	Njësia	Sasia e pritshme	Çmimi për njësi lekë pa TVSH	Vlera lekë pa TVSH (4 x 5)
	1. NENSHTRESA DHE SHTRESA NE TERRITORIN E NDERTESAVE				
2.267 /a	Shtrese me pllaka grez porcelanato	m ²	20		
	2. PUNIME TAVANI DHE SUVATIMI				
2.310	Suva brenda mur tulle ~ 4m, me krah, llaç perzier M 25	m ²	20		
2.326	Veshje me pllake majolike	m ²	20		
2.328 /1	Patinim muri me stuko	m ²	20		
2.330 /1	Patinim tavani me stuko	m ²	20		
2.331	Suva e zakonshme fasade mur tulle ~ 8m	m ²	20		

2.332	Suva e zakonshme fasade mur guri ~ 8m	m ²	20		
2.297 /b	Tavan i varur me pllaka gipsi 60x60cm	m ²	20		
2.297 /2b	Veshje muri me kartonxhes	m ²	20		
	3. PUNIME DYER DRITARE	m ²			
2.375 /2a	Dritare d/alumini dyfi xh.	m ²	5		
2.383	F.V dyer druri	m ²	5		
2.395 /a	Dyer d/alumini me mbushje element d/a.	m ²	5		
	4. PUNIME BOJATISJE	m ²			
2.399	Sherbetisje e bojatisje me gelqere	m ²	500		
2.404	Boje hidroplastike	m ²	500		
2.451	Lyerje me hidromat, 2 duar	m ²	500		
	5. INSTALIME PER NDRICIM				
2.481	F.V percjelles PV-500 Ø 1 mm2	ml	200		
2.481 /2	F.V percjelles PV-500 Ø 2.5 mm2	ml	200		
2.482	F.V percjelles PPV Ø 2x1 mm2	ml	200		
2.482 /1	F.V percjelles PPV Ø 2x1.5 mm2	ml	200		
2.483	F.V Çelesa e priza 10 A	copë	25		
2.485	F.V Çelesa e priza 10 A me nulifikim	copë	25		
2.486	F.V Portollampa norm 10 A	copë	25		
2.485 /b	F.V priza bivalente 220V 10A 2P-T	copë	30		
2.485 /d	F.V priza shuko universal	copë	30		
2.485 /e	F.V priza shuko jashte murit 2P+T IP=54	copë	30		
2.485 /1	F.V Çeles 1 polar 220V 10A	copë	30		
2.485 /4	F.V Çeles 2 polar 220V 10A	copë	30		
2.490 /1b	F.V Automat termo/el.manj. diferencial 2P 220V, 16A	copë	10		
2.490 /1c	F.V Automat termo/el.manj. diferencial 2P 220V, 32A	copë	10		

2.490 /1d	F.V Automat termo/el.manj. diferencial 2P 220V, 40A	copë	10		
2.490 /1e	F.V Automat termo/el.manj. diferencial 2P 220V, 63A	copë	5		
2.457	F.V. Ndricues fluoreshent 1x18w.IP65	copë	10		
2.458	F.V. Ndricues fluoreshent 1x40w.IP65	copë	10		
2.466	F.V. Ndricues tavanor fluoreshente 1x40w	copë	10		
2.467	F.V. Ndricues tavanor fluoreshente 1x18w	copë	10		
2.471	F.V. Ndricues fluoreshent 4x18w,IP40	copë	5		
2.472	F.V. Ndricues fluoreshent 2x40w,IP40	copë	5		
2.473	F.V. Ndricues evakuimi me llampe 1x11w,IP40	copë	2		
2.481 /1	F.V percjelles PV-500 Ø 1.5 mm2	ml	200		
2.490 /b	F.V Kasete plastike KE me 6 modular (vende)	copë	5		
	6. INSTALIME HIDRO-SANITARE DHE NGROHJE				
2.493	F.V tub te zeze dhe rakorderi	kg	5		
2.536	F.V tuba çeliku Ø ~ 200mm	kg	5		
2.495	F.V lavaman porcelani	copë	5		
2.501	F.V WC allafrenga	copë	5		
2.504	F.V WC allaturka	copë	5		
2.513	F.V pilete dysHEMEJE Ø 30	copë	5		
2.514	F.V pilete dysHEMEJE Ø 40	copë	5		
2.491 /b	FV Tuba e rakorderi ujesjellesi PPR d=20~25mm, Pn 16	ml	5		
2.215	F V bolier 80 liter, uje te ngrohTE	copë	5		
2.217	F V bolier 12 liter, uje te ngrohTE sanitar	copë	5		
2.491 /a	FV Tuba e rakorderi ujesjellesi PPR d=20~25mm, Pn 25	ml	5		
	7. ANALIZA JASHTE LISTE				
An	F.V Fisheke per dyer duralumini	copë	20		
An	F.V Fisheke per dyer druri	copë	20		
An	F.V Brava per dyer duralumini	copë	5		
An	F.V Brava per dyer druri	copë	5		
An	F.V Doreza per dyer druri	copë	5		
An	F.V Doreza per dyer duralumini	copë	5		

An	F.V Brava + Mentasha (dye druri)	komplet	5		
An	F.V Mekanizem + Mentasha + Doreza (dritare duralumini)	komplet	5		
An	F.V Brava + Mentasha (dere duralumini)	komplet	5		
An	F.V Ndricesa luminishent FL 2x18w, IP40 PAR	copë	3		
An	F.V Ndrices inkaso te jashtem, 1x11w, 250v, IP65	copë	2		
An	F.V Llamp LED 18w	copë	20		
An	F.V Ndricesa LED 80w per tarrace	copë	3		
An	F.V Pakete elektronike per pompa te ujit te pijshem 0.9kw	copë	2		
An	F.V Tubo e rekorderi PE d=20-32mm PN16	ml	15		
An	F.V Tubo e rekorderi PPR d=20-25mm PN25	ml	15		
An	F.V Tubo e rekorderi PPR d=20-25mm PN16	ml	15		
An	F.V Tubo fleksibel 40cm	copë	20		
An	F.V Tubo fleksibel 50cm	copë	20		
An	F.V Tubo fleksibel 70cm	copë	5		
An	F.V Tubo fleksibel dushi 150mm	copë	5		
An	F.V Telefon dushi	copë	5		
An	F.V Kasete wc plastike 30-40L per wc allafrenga import	copë	20		
An	F.V Rezistenca Bolieri 80L, 4KW	copë	10		
An	F.V Termostat Bolieri 80L	copë	10		
An	F.V Lavaman porcelani importi me mishelator (gjeresia e lavamanit jo me e vogel se 60cm)	copë	5		
An	F.V Kollone lavamani porcelani (lartesi jo me pak se 70cm)	copë	5		
An	F.V Kapak wc plastik I pershtatshem per wc allafrenga importi	copë	10		
An	F.V Grup dushi i thjeshte	copë	5		
An	F.V Grup dushi mishelator	copë	10		
An	F.V Grup lavamani mishelator	copë	5		
An	F.V Grup lavamani i thjeshte	copë	5		
An	F.V Pileta dyshemeje 50mm	copë	3		
An	Kontroll difekti, riparim sistemi ujit te pijshem	op	10		
An	Kontroll difekti, riparim sistemi ujerave te zeza	op	5		

An	Kontroll difekti, riparim sistemi zjarrfikes-hidranti	op	5		
An	Pastrimi i filterave te ujit te pompave	copë	5		
An	Kontrolli dhe tarimi i sensoreve te nivelit te depozitave	copë	2		
An	Lubrikimi i motorreve te pompave	copë	4		
An	Saracineska 2 1/2	copë	2		
An	Kundravalvul 2 1/2	copë	2		
	Çmimi total				_____

Çmimi Neto pa TVSH					
TVSH (%)					
Çmimi total me TVSH:					
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit					
Nënshkrimi					
Vula					
Datë _____					

Shtojca 3.

[Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)
[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

* * *

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërmbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]**Shtojca 4.**

(Shtojcë për t'u paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit**Nënshkrimi****Vula**

Shtojca 5.

(⁶Shtojcë për t'u plotësuar nga operatori ekonomik)

DEKLARATË

Mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit

Deklaratë për procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Unë i nënshkruari _____, në cilësinë e anëtarit të stafit të operatorit ekonomik “.....” për procedurën e prokurimit me objekt _____ nën përgjegjësinë time personale, **Deklaroj** se:

1. Autorizoj VETËM operatorin ekonomik “.....” të paraqesë personin tim dhe të gjithë dokumentacion e nevojshëm, si anëtar i stafit të tij në procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Deklarimi i personit tim, si anëtar i stafit nga ana e çdo operatori ekonomik tjetër, për procedurën e prokurimit me objekt _____, është i pamiratur dhe pa pëlqimin e personit tim.

2. Jam i disponueshëm në realizimin e objektit të prokurimit, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara nga autoriteti kontraktor.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi

Vula

⁶ Kjo Shtojcë do të paraqitet në rastin e kontratave për shërbime me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme.

Shtojca 6 .

[*Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor*]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Objekti: Mirëmbajtje e sistemit elektrik, hidraulik, impiantistikës dhe godinave të Spitalit Sarandë

TE PERGJITHSHME

1. HYRJE

Qellimi i këtij kapitulli është sqarimi i kërkesave për kontraktorin në lidhje me preventivin. Kryerja e punimeve konform kushteve teknike, kontrates, ligjit në fuqi për mbrojtjen e punetoreve, mjedisin, publikun, si dhe detyrimet që duhet të plotësojë kontraktori gjatë zbatimit të punimeve.

1.1 Zevendesimi i materialeve

Zevendesimet e materialeve të specifikuar në preventiv do të behen me miratimin e investitorit. Keto zevendesime do të behen vetëm nëse materiali i propozuar ka cilësinë e njëjte ose më të mirë. Duhet të theksohet se nuk do të njihet asnjë shtesë ose ndryshim i cmimit për njësi, të ofruar nga kontraktori në ofertën e tij dhe të pasqyruar në preventivin final.

1.2 Paketimi dhe transporti

Kontraktuesi do të jetë përgjegjës për transportimin e të gjitha materialeve dhe pajisjeve nga pika e prodhimit deri në vendin e vendosjes. Kontraktori do të përgatitë të gjitha materialet për dërgesë dhe ruajtjen në atë mënyrë për t'i mbrojtur ato nga demtimi apo zhvlerësimi dhe do të jetë përgjegjës për çdo dëm për shkak të përgatitjes të pa sakte për ngarkim dhe dërgesë. Të gjitha pjesët duhet të jenë të paketuara me kujdes dhe të gjitha hapjet do të jenë të mbyllura fort para se të dërgohen. Pajisjet që do të jenë vulnerable ndaj dëmeve për shkak të lageshtisë gjatë transportit ose ruajtjes, do të jenë të mbrojtura nga barrierë të përshtatshme. Copa të renda duhet të montohen në pllaka dhe të fiksohen me vida; pllakat duhet të jenë të mjaftueshme për të dhënë mbështetjen dhe për të shmangur shtremberimin.

1.3 Pastrimi i Kantierit

Në fund të punimeve, kontraktori duhet të pastrojë, me shpenzimet e tij të gjitha pajisjet e ndërtimit, makineritë e vecanta, pajisjet, mbeturinat e ndryshme, etj. Në fund të punimeve, kontraktori duhet të pastrojë kantierin, dhe ta kthejë në gjendje të pranueshme, ose më mirë se në gjendjen e mëparshme.

1.4 Grafiku i punimeve

Kontraktuesi duhet t'i japë AK një program të plotë duke i treguar rendin, procedurën dhe metodën sipas së cilave, ai propozon të punohet deri në mbarim të punës ose riparimit të defektit.

1.5 Punime të gabuara

Cdo punë, që nuk është në përputhje me këto specifikime, duhet refuzuar dhe kontraktuesi duhet të riparojë cdo defekt me shpenzimet e veta, sipas preventivit.

1.6 Heqja e dyerve dhe dritareve

Heqje dyerësh dhe dritarësh, që realizohet para prishjes së murit, duke përfshirë kasën, telajot, etj. Sistemin e materialit që ekziston brenda ambientit të kantierit dhe grumbullimin në një vend të caktuar në kantier për ripërdorim.

1.7 Suvatim i brendshëm

Sprucim i mureve dhe tavaneve me ilaç cimentoje të lenget, për permiresimin e ngjites së suvase dhe rforcimin e sipërfaqeve të muratës. Suvatim i realizuar nga një shtresë me trashësi 2 cm llaci bastard m-25 me përmbajtje për m^2 : rërë e larë $0,005 m^3$; llac gelqerëje m- 1: 2, $0.03 m^3$; cimento 400, 6.6 kg; ujë, i aplikuar me paravendosje të drejtuesve në mure (shiritit me llac me trashësi 15 cm cdo 1 deri në 1,5 m), dhe e lëmuar me mistri e bardhë, për ta përfunduar plotësisht suvatimin.

1.8 Patinimi

Patinaturë muri realizohet me stuko, cimento dhe me gelqerë të cilësia të lartë, mbi sipërfaqe të suvatuara me parë dhe të niveluara, me përmbajtje: gelqerë 3 kg për m^2 . Lartësia e patinaturave për ambientet e ndryshme të ndërtesës duhet të vendoset nga AK përfshirë dhe cdo punë tjetër dhe kërkesë për ta konsideruar patinaturën të përfunduar dhe të gatshme për tu lëyer me cdo lloj bojë.

1.9 Lyerje me bojë hidroplastike

Përpara fillimit të punimeve, kontraktori duhet t'i paraqesë operatorit, cilësia dhe katalogun e nuancave të ngjyrave të bojës, që ai mendon të përdorë. Nuk lejohet perzierja e dy llojeve të ndryshme markash bojë gjatë procesit të punës. Hollimi i bojës duhet të bëhet vetëm sipas udhëzimeve të prodhuesit. Përpara fillimit të lyerjes duhet që të gjitha pajisjet, mobiljet ose objekte të tjera që ndodhen në objekt të mbulohen në mënyrë që të mos bëhen me bojë. Është e domosdoshme, që pajisjet ose mobiljet që janë të mbështetura ose të varura në mur të largohen në mënyrë që të bëhet një lyerje komplete e objektit. Materiali i pastrimit të njollave duhet të jetë me përmbajtje të ulët toksikimi. Pastrimi dhe lyerja duhet të koordinohen në atë mënyrë që gjatë pastrimit të mos ngrihet pluhur ose papastërti dhe të bëjë mbi sipërfaqen e sapolyer. Furcat, kovat

dhe enet e tjera ku mbahet boja duhet te jene te pastra. Ato duhet te pastrohen shume mire perpara qdo perdorimi sidomos kur duhet te punohet me nje ngjyre tjeter. Gjithashtu, duhet te pastrohen kur mbaron lyerja ne cdo dite. Personeli qe do te kryejë lyerjen, duhet te jete me eksperience ne kete fushe dhe duhet te zbatoje te gjitha kushtet teknike te lyerjes sipas KTZ dhe STASH.

2.0 Lyerja me boje hidromat

Proqesi i lyerjes se siperfaqeve te mureve dhe tavanëve kalon neper tre faza si me poshte:

1- Pergatitja e siperfaqes qe do te lyhet -Para lyerjes duhet te behet kruajtja e ashper e bojes se meparshme nga siperfaqja e lyer, mbushja e gropave te vogla apo demtimeve te siperfaqes se murit me ane te stukimit me material sintetik dhe berja gati per paralyerje. Perpara fillimit te procesit te lyerjes duhet te behet mbrojtja e siperfaqeve qe nuk do te lyhen (dyer, dritare, etj.) me ane te vendosjes se letrave mbrojtese.

2- Paralyerja e siperfaqes se pastruar - Ne fillim te procesit te lyerjes, behet paralyerja e siperfaqeve te pastruara mire me gelqeren te holluar (Astari). Per paralyerjen behet perzierja e 1 kg gelqere me nje liter uje. Me perzierjen e pergatitur behet paralyerja e siperfaqes vetem me nje dore. Norma e perdorimit eshte 1liter gelqere e holluar duhet te perdoret per 2 m² siperfaqe.

3- Lyerja me boje hidromat e siperfaqes - Ne fillim behet pergatitja e perzierjes se bojes hidromat te lenget e cila eshte e paketuar ne kuti 5-15 litershe. Lengu i bojes hollohet me uje ne masen 20 - 30%. Kesaj perzierje i hidhet pigmenti deri sa te merret ngjyra e deshruar dhe e aprovuar nga Supervizori i punimeve dhe pastaj behet lyerja e siperfaqes. Lyerja behet me dy duar. Norma e perdorimit eshte 1liter boje hidromat i holluar duhet te perdoret per 2.7 - 3m² siperfaqe. Kjo norme varet nga ashpersia e siperfaqes dhe lloji i bojes se meparshme.

2.1 Riparimi i dysHEMEVE me pllaka

Riparimi per pllakat e demtuara ose per ato pllaka qe mungojne, te behet ne kete menyre:

- Pllakat e demtuara duhen hequr megjithe llaqin ne nje trashesi te pakten 2 cm. Pastaj duhet, qe vendi te pastrohet dhe te lahet me uje me presion. Pllakat e reja te jene me te njejten ngjyre dhe me dimensione te njejta si pllakat e vjetra dhe te vendosen ne llacin e shtruar. Llaci per riparim duhet te pergatitet me permbajtje: per 1,02 m² pllaka nevojiten 0,02 m³ Hag te tipit m-15 me 4 kg cemento.
- Pastaj, duhet qe fugat te mbushen me masen perkatese (bojak), te pastrohen dhe te kryhen te gjitha punet e tjera.

2.2 Dritaret/informacion i pergjithshem/kerkesat

Dritaret jane pjese e rendesishme arkitektonike dhe funksionale e ndertesës. Ato sigurojne ndricimin per pjeset e siperfaqes se brendshme te tyre. Madhesia e tyre variojne, varet nga kompozimi arkitektonik, nga madhesia e siperfaqes se brendshme dhe kerkesat e tjera te projektuesit. Dritaret duhet te jene ne kuote 80-90 cm mbi nivelin e dyshemese, kjo varet dhe nga kerkesat e projektuesit. Dritaret mund te jene te prodhuara me dru, alumin ose PVC. Pjeset kryesore te dritareve jane: Kasa e dritares qe fiksohet ne mur me elemente prej hekuri perpara suvatimit. Korniza e dritares do te vidhohet me kasën e saj mbas suvatimit dhe bojatisjes. Korniza do te pajiset ne kase me mentesha dhe bllokues te tipeve te ndryshme te instaluar ne te. Kanate me xhama te hapshem, te pajisur me mentesha, doreza te fiksuara dhe me ngjites transparent silikon, si dhe me kanata fikse.

2.3 Dyerte brendshme

a) Dyer te brendshme MDF

Furnizimi dhe instalimi i dyerve te brendshme prej materiali MDF dimensionet e te cilave jepen nga Porositesi, perbehet nga:

- Nje kase e bere me dru pishe te stazhionuar (me trashesi 4 cm) e trajtuar me nje mbulesë mbrojtëse te drunjte, e dimensionuar sipas gjerësisë së murit, (duke marrë parasysh edhe rritjen prej mbulesës së murit) mberthet fuqishem ne mur me vida hekuri cdo nje meter) dhe me llac cemento.
- Nje kornize e kases se drurit qe fiksohet, tek kasa e drurit e dhene me siper, pas suvatimit dhe lyerjes.
- Kanatet hapese te dyerve te bera me material MDF te nje cilesie te larte dhe shirita ndermjet druri te forte te siguruar nga nje brave sigurie. Dy panelet e melamise do te jene 8 mm te trasha dhe te gjitha kufijte e derës do te mbrohen nga nje shirit druri i forte. Trashesia totale e dyerve do te jete 4,5 cm minimalisht dhe duhet te varen te pakten nga 3 mentesha me gjerësi minimale 16 cm.
- Nje brave metalike dhe tre kopje celesash tip sekrete, doreza dyershe dhe doreze shtytëse te derës.
- Mbyllja behet me shirita solide druri, te cilat vendosen perreth perimetrit te derës me ane te thumbave, pune qe duhet te behet me cilesi, sipas te gjitha kerkesave te duhura teknike qe duhen per kompletimin e kesaj pune.

2.4 Bravat

Furnizimi dhe fiksimi i bravave te celikut tip sekret, sipas pershkrimeve ne vizatimet teknike. Pjeset kryesore perberese te tyre jane:

- Mbulesa mbrojtëse
- Fisheku i kyçjes dhe vidat e tij

-
- Shasia prej celiku
 - Celesat
 - Dorezat

Bravat mund te jene:

- Brava tip Tubolare
- Brava me Leve tip tubolare
- Brava Tip Cilindrike
- Brava me leve tip Cilindrike

2.3 Manteshat

Furnizimi dhe fiksimi i menteshave te bera me material celiku inoks ose te veshur me shtrese bronxi, do te behet sipas standartit dhe cilesise. Materiali i celikut duhet te siguroje qendrueshmerine e larte te menteshave, mos thyeshmerine e tyre ndaj goditjeve mekanike, elasticitetin e duhur te menteshave, jetegjatesine prej 180 000 cikle jete gjate punes, etj

2.6 Dorezat Të përgjithshme

Dorezat e dyereve / dritareve duhet te jene te njejta ne te gjitha ambientet e qendres sociale. Ne menyre qe te plotesohet ky kusht duhet qe keto doreza te jene te tilla, qe mund te perdoren si ne ambientet e thata ashtu edhe ne ato me lageshtire.

2.7 Tavan i varur dhe pllaka gipsi/alumini

Specifikimi i tavaneve: tavanet e varur zakonisht jane te ndare me panele dhe perimetri eshte i barabarte ose me i madh ne gjeresi sesa $\frac{1}{2}$ e modelit te pllakes se plote. Keto panele duhet te priten ne, madhesi te pershtatshme me skeleton perberes te tavanit te varur. Drejtimi i instalimit duhet te jete i treguar mbi planet e tavanit

Shtojca 7.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

Shërbimet që kërkohen që kërkohen:

Afatet e ekzekutimit:

1		2	4
Nr.	Nr. Analizë	Emërtimi	Sasia e pritshme
		1. NENSHTRESA DHE SHTRESA NE TERRITORIN E NDERTESAVE	
1	2.267/a	Shtrese me pllaka grez porcelanato	20 m ²
		2. PUNIME TAVANI DHE SUVATIMI	
2	2.310	Suva brenda mur tulle ~ 4m, me krah, llaç perzier M 25	20 m ²
3	2.326	Veshje me pllake majolike	20 m ²
4	2.328/1	Patinim muri me stuko	20 m ²
5	2.330/1	Patinim tavani me stuko	20 m ²
6	2.331	Suva e zakonshme fasade mur tulle ~ 8m	20 m ²
7	2.332	Suva e zakonshme fasade mur guri ~ 8m	20 m ²
8	2.297/b	Tavan i varur me pllaka gipsi 60x60cm	20 m ²
9	2.297/2b	Veshje muri me kartonxhes	20 m ²
		3. PUNIME DYER DRITARE	
10	2.375/2a	Dritare d/alumini dyfi xh.	5 m ²
11	2.383	F.V dyer druri	5 m ²
12	2.395/a	Dyer d/alumini me mbushje element d/a.	5 m ²
		4. PUNIME BOJATISJE	
13	2.399	Sherbetisje e bojatisje me gelqere	500 m ²
14	2.404	Boje hidroplastike	500 m ²
15	2.451	Lyerje me hidromat, 2 duar	500 m ²
		5. INSTALIME PER NDRICIM	
16	2.481	F.V percjelles PV-500 Ø 1 mm2	200 ml
17	2.481/2	F.V percjelles PV-500 Ø 2.5 mm2	200 ml
18	2.482	F.V percjelles PPV Ø 2x1 mm2	200 ml
19	2.482/1	F.V percjelles PPV Ø 2x1.5 mm2	200 ml
20	2.483	F.V Çelesa e priza 10 A	25 copë
21	2.485	F.V Çelesa e priza 10 A me nulifikim	25 copë

22	2.486	F.V Portollampa norm 10 A	25 copë
23	2.485/b	F.V priza bivalente 220V 10A 2P-T	30 copë
24	2.485/d	F.V priza shuko universal	30 copë
25	2.485/e	F.V priza shuko jashte murit 2P+T IP=54	30 copë
26	2.485/1	F.V Çeles 1 polar 220V 10A	30 copë
27	2.485/4	F.V Çeles 2 polar 220V 10A	30 copë
28	2.490/1b	F.V Automat termo/el.manj. diferencial 2P 220V, 16A	10 copë
29	2.490/1c	F.V Automat termo/el.manj. diferencial 2P 220V, 32A	10 copë
30	2.490/1d	F.V Automat termo/el.manj. diferencial 2P 220V, 40A	10 copë
31	2.490/1e	F.V Automat termo/el.manj. diferencial 2P 220V, 63A	5 copë
32	2.457	F.V. Ndricules fluoreshent 1x18w.IP65	10 copë
33	2.458	F.V. Ndricules fluoreshent 1x40w.IP65	10 copë
34	2.466	F.V. Ndricules tavanor fluoreshente 1x40w	10 copë
35	2.467	F.V. Ndricules tavanor fluoreshente 1x18w	10 copë
36	2.471	F.V. Ndricules fluoreshent 4x18w,IP40	5 copë
37	2.472	F.V. Ndricules fluoreshent 2x40w,IP40	5 copë
38	2.473	F.V. Ndricules evakuimi me llampe 1x11w,IP40	2 copë
39	2.481/1	F.V percjelles PV-500 Ø 1.5 mm2	200 ml
40	2.490/b	F.V Kasete plastike KE me 6 modular (vende)	5 copë
6. INSTALIME HIDRO-SANITARE DHE NGROHJE			
41	2.493	F.V tub te zeze dhe rakorderi	5 kg
42	2.536	F.V tuba çeliku Ø ~ 200mm	5 kg
43	2.495	F.V lavaman porcelani	5 copë
44	2.501	F.V WC allafrenga	5 copë
45	2.504	F.V WC allaturka	5 copë
46	2.513	F.V pilete dysHEMEJE Ø 30	5 copë
47	2.514	F.V pilete dysHEMEJE Ø 40	5 copë
48	2.491/b	FV Tuba e rakorderi ujesjellesi PPR d=20~25mm, Pn 16	5 ml
49	2.215	F V bolier 80 liter, uje te ngrohje	5 copë
50	2.217	F V bolier 12 liter, uje te ngrohje sanitar	5 copë
51	2.491/a	FV Tuba e rakorderi ujesjellesi PPR d=20~25mm, Pn 25	5
7. ANALIZA JAShte LISTE			
52	An	F.V Fisheke per dyer duralumini	20
53	An	F.V Fisheke per dyer druri	20
54	An	F.V Brava per dyer duralumini	5
55	An	F.V Brava per dyer druri	5
56	An	F.V Doreza per dyer druri	5
57	An	F.V Doreza per dyer duralumini	5
58	An	F.V Brava + Mentasha (dyer druri)	5
59	An	F.V Mekanizem + Mentasha + Doreza (dritare duralumini)	5
60	An	F.V Brava + Mentasha (dere duralumini)	5
61	An	F.V Ndriculesa luminishent FL 2x18w, IP40 PAR	3
62	An	F.V Ndricules inkaso te jashtem, 1x11w, 250v, IP65	2
63	An	F.V Lllampa LED 18w	20
64	An	F.V Ndriculesa LED 80w per tarrace	3
65	An	F.V Pakete elektronike per pompa te ujit te pijshem 0.9kw	2

66	An	F.V Tubo e rekorderi PE d=20-32mm PN16	15
67	An	F.V Tubo e rekorderi PPR d=20-25mm PN25	15
68	An	F.V Tubo e rekorderi PPR d=20-25mm PN16	15
69	An	F.V Tubo fleksibel 40cm	20
70	An	F.V Tubo fleksibel 50cm	20
71	An	F.V Tubo fleksibel 70cm	5
72	An	F.V Tubo fleksibel dushi 150mm	5
73	An	F.V Telefon dushi	5
74	An	F.V Kasete wc plastike 30-40L per wc allafrenga import	20
75	An	F.V Rezistenca Bolieri 80L, 4KW	10
76	An	F.V Termostat Bolieri 80L	10
77	An	F.V Lavaman porcelani importi me mishelator (gjerësia e lavamanit jo me e vogël se 60cm)	5
78	An	F.V Kollone lavamani porcelani (lartësi jo me pak se 70cm)	5
79	An	F.V Kapak wc plastik I pershtatshëm për wc allafrenga importi	10
80	An	F.V Grup dushi i thjeshtë	5
81	An	F.V Grup dushi mishelator	10
82	An	F.V Grup lavamani mishelator	5
83	An	F.V Grup lavamani i thjeshtë	5
84	An	F.V Pileta dysHEMEJE 50mm	3
85	An	Kontroll difekti, riparim sistemi ujë të pijshëm	10
86	An	Kontroll difekti, riparim sistemi ujërave të zeza	5
87	An	Kontroll difekti, riparim sistemi zjarrfikës-hidranti	5
88	An	Pastrimi i filterave të ujë të pompave	5
89	An	Kontrolli dhe tarimi i sensoreve të nivelit të depozitave	2
90	An	Lubrifikimi i motorreve të pompave	4
91	An	Saracineska 2 1/2	2
92	An	Kundravalvul 2 1/2	2

Zërat e mirëmbajtjes për shërbimin do të kryhen sipas përshkrimit në specifikimet teknike, në godinat e Spitalit Sarandë, sipas nevojave të Autoritetit Kontraktor, Brenda afatit të vlefshmërisë së marrëveshjes kuadër.

Shtojca 8.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

TERMAT E REFERENCES

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve:

Mirëmbajtje e sistemit elektrik, hidraulik, impiantistikës dhe godinave të spitalit Sarandë.

Qëllimi:

Funksionimi normal i sistemeve, pajisjeve elektrike dhe hidraulike, dyerve dhe dritarve të spitalit Sarandë.

Detyrat: - Realizimi i kryerjes së punimeve për mbarëvajtjen dhe mirëfunksionimin e paisjeve elektrike, hidraulike etj.

- Monitorim
- Diagnostikim
- Mirëmbajtje parandaluese
- Ndërhyrje për zgjidhjen e problemeve
- Zëvendësim i pjesëve të dëmtuara/servisimi i tyre
- Realizimi i kryerjes së punimeve të mirëmbajtjes së sistemit elektrik, hidraulik, dyerve, dritareve, mureve, tavaneve, dyshemesë me cilësi të lartë dhe sipas specifikimeve teknike të hartuara nga AK.
- Punimet e mirëmbajtjes dhe riparimet do të kryhen pa penguar aktivitetin spitalor.

Shpërndarja: Në Ambientet e Autoritetit Kontraktor "Drejtore të Shërbimit Spitalor " Sarandë.

Vendi dhe dorëzimi i shërbimeve: Do të jete nga momenti i nënshkrimit të kontratës/kontratave, sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktor, brenda afatit 12 (dymbëdhjetë) muaj nga lidhja e Marrëveshjes Kuadër.

Shtojca 9.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënua për ndonjë veprë penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënua ose nuk ka qenë i dënua nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo veprë penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi;
- j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.
- k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas **Shtojcës 10**.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Sipas kriterëve të përgjithshme të kualifikimit, të përcaktuara në pikën 1, Shtojca 9 të DST.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të 3 (tre) viteve të fundit financiare (2022-2023-2024), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vlerës së fondit limit.

Kërkesa e mësipërme konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % e vlerës së fondit limit.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

2.3.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur me licensë profesionale të vleshme, të lëshuar nga autoritetet kompetente shtetërore, për kategorinë:

- **NP-3 A** Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasada

2.3.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar stafin teknik, për realizimin e shërbimeve objekt prokurimi, sipas profileve të mëposhtme:

Nr.	Stafi	Nr.
1	Drejtues Teknik, i përfshirë në licencën profesionale të ofertuesit, me profil Inxhinier Ndërtimi/Hidroteknik	1 (një)
2	Punonjës ndërtimi/Suvatimi/Murator	1 (një)
3	Elektracist	1 (një)
4	Hidraulik	1 (një)
5	Bojaxhi	1 (një)
	Total	5 (pesë)

Për punonjësin në pikën 1, duhet të paraqitet:

- Diplomë përkatëse
- kontratë pune të vlefshme gjatë periudhës së vlefshmërisë së marrëveshjes kuadër

Për punonjësit në pikën 2,3,4,5 duhet të paraqitet:

- kontratë pune të vlefshme gjatë periudhës së vlefshmërisë së marrëveshjes kuadër
- dëshmi aftësie profesionale (të vlefshme), sipas Ligjit Nr.15/2017, "Mbi arsimin dhe formimin profesional", i ndryshuar

Ky Kriter konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 10 të DT. Dokumentet provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

2.3.4 Operatori ekonomik, duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës merr përsipër kryerjen e shërbimeve të mirëmbajtjes objekt prokurimi, nga punonjës të pajisur me uniformën e punës, me materiale/ pajisje mbrojtëse personale për shëndetin dhe sigurinë teknike në punë.

